

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË RROGOZHINË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Rrogozhinë**, me objekt: “*Mbi auditimin e llogarive vjetore të administratës së institucionit, auditimi i zonave të llogarisë, krijimi dhe përdorimi i ardhurave, menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm*”, lloji i auditimit: “*Auditim financiar*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.09.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 22, datë 25.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 939/8, datë 28.3.2014, i ka rekomanduar z. Ndririm Dushku, Kryetar i Bashkisë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në zbatim të planit të buxhetit të përpilohet regjistri i parashikimit të prokurimeve publike dhe të ndiqet realizimi i tyre. Për prokurimet publike të realizuara të hartohet regjistri përkatës dhe të dërgohen periodikisht në Agjensinë e Prokurimit Publik.

Menjëherë

2. Për të pasqyruar veprimtarinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të mbahen procesverbale për çdo hap të zhvillimit të tenderit, në mënyrë që të bëhet e mundur transparenca dhe auditimi i tenderit në çdo kohë.

Vazhdimisht

3. Në rastet e marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit, shërbimeve të kryera dhe marrjes së mallrave e materialeve në dorëzim, të ngihet një komision me urdhër të veçantë, me të paktën 3 specialistë të fushës, sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.11.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Vazhdimisht

4. Nga Njësia e Prokurimit të cilësohet në dokumentet e tenderit kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ato kanë seli dhe zhvillojnë veprimtarinë.

Vazhdimisht

5. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejt kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organe kompetente.

Vazhdimisht

6. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, në Bashkinë Rrogozhinë të merren masa që për aktivitetin fiskal në vitin 2014, dosjet e subjekteve të plotësohen me:

- Deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor;
- Njoftim vlerësimi tatimor;
- Njoftim detyrimit;
- Dokumenti i Pagesës së detyrimit, (Mandat arkëtimi);
- Gent Planet apo planimetritë për taksën e ndërtesave,

-Akt- konstatimet apo Akt -verifikimet për mbylljen e aktivitetit, të konfirmuara dhe nga - Policia bashkiake.

Dokumente këto, të përcaktuara në kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar.

Brenda 6 muajit-I 2014

7. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, në Bashkinë Rrogozhinë të merren masa për hartimin e planit vjetor të kontrolleve në drejtimet e përcaktuara, sipas kërkesave të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, pika 10, “Kontrolli tatimor”.

Brenda 6 muajit-I 2014

8. Nga Zyra e Taksave Vendore në Bashkinë Rrogozhinë, bazuar në nenin 70, pika 3, “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, për 31 subjektet (sipas Aneksit nr. 2) të evidentuara si të palicensuara, të kryhen llogaritjet, për detyrimet e gjobat dhe të nxirren njoftimet e vlerësimit për detyrimet që kanë ndaj Bashkisë, për vlerën gjithsej **2,333,810 lekë**, dhe të kërkohet arkëtimi i kësaj vlere.

Brenda 6 muajit-I 2014

9. Nga ana e Zyrës së taksave të Bashkisë Rrogozhinë, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitore të pa likuiduara deri më datën 30.9.2013 për të 4 llojet e taksave të popullatës në vlerën 10,345 mijë lekë, përkatësisht: për taksën e tokës, në vlerën 5.945,00 lekë, taksa e banesave në vlerën 2,203,000 lekë, taksa e pastrimit në vlerën 1,475,000 lekë dhe taksë ndriçimi e gjelbërimi 722,000 lekë.

Brenda 9 muajit 2014

10. Nga ana e Zyrës së Taksave të Bashkisë Rrogozhinë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Zyrën e Financës, të merren masa në zbatim të procedurave ligjore, për arkëtimin e vlerës **13,401,690 lekë** për **159 subjekte debitorë të biznesit të vogël dhe të madh**, (Sipas aneksit 3), të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i gjobës në masën 25 për qind të detyrimit të pa paguar në afate ligjore, për 124 subjekte për vlerën **1,399,375 lekë, gjithsej 14,801,065 lekë**.

Brenda 9 muajit 2014

11. Të merren masa nga Bashkia Rrogozhinë, për krijimin e Zyrës së Menaxhimit të Aseteve, e cila të kryejë inventarizimin, vlerësimin, regjistrimin e asetëve në ZVRPP, marrjen në dorëzim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, dhënien e tyre me qira dhe regjistrimin e asetëve në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabilitetin, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, VKM. nr. 624, datë 07.9.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Rrogozhinë, të Qarkut Tiranë”, me qëllim administrimin e tyre dhe sigurimin e të ardhurave për Bashkinë.

Brenda 9 muajit 2014

12. Të merren masa për zbatimin e procedurave të prokurimit, sipas kërkesave të udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008, “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” dhe të mos kryhen pagesa pa u plotësuar dokumentacioni përkatës, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Vazhdimisht

13. Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa që në programimin e buxhetit, të përcaktohet kufiri monetar për mallra e shërbime të ngjashme, të përcaktohen sasitë vjetore dhe vlera respektive, bazuar në çmimet e publikuara nga INSTATI dhe institucionet e tjera përkatëse, apo sipas testimi të tregut për të mos përdorur gjatë vitit padrejtësisht procedurën “Blerje në vlera të vogla”.

Vazhdimisht

14. Në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit, titullari i njësisë publike (Bashkisë), të hartojë politikat, të miratojë dhe monitorojë objektivat e njësisë publike që ai drejton, planet strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Të ngrihet grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike, i cili të përbëhet nga titullari i njësisë publike dhe të kryesohet prej tij sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Brenda 6 muajit-I 2014

15. Të ngrihet e miratohet një sistem për komunikimin dhe përcjelljen e informacionit ndërmjet sektorëve dhe eprorëve si pjesë e llogaridhënies, bashkëpunimit dhe e kontrollit të brendshëm, duke vendosur një sistem efikas të kontrollit të brendshëm.

Brenda 6 muajit-I 2014

16. Të hartohet dhe të miratohet rregullore e brendshme mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin” dhe aktet e tjera në zbatim të tij, duke përshkruar kërkesat dhe detyrat për çdo vend pune në administratën e Bashkisë.

Brenda 6 muajit-I 2014

17. Nga bashkia të miratohet një sistem i rregullave specifike të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. III.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Bashkia Rrogozhinë të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën 5,825,946 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Në shumën **2,296,000 lekë**, për vlerën e dëmit të krijuar për mos pagesën e taksës së biznesit të vogël nga subjektet private të transportit të paregjistruara, që ju janë dhënë certifikata transporti, por që nuk janë të regjistruar në QKR për tu licencuar për aktivitete të ndryshme biznesi, e konkretisht: për vitin 2011, për 18 subjekte në vlerën 728,000 lekë, për vitin 2012 për 31 subjekte në vlerën 1,248,000 lekë dhe për 9 –të muajin e vitit 2013 për 8 subjekte në vlerën 320,000 lekë. (sipas aneksit nr. 1) Nga ana e Zyrës së Taksave të Bashkisë Rrogozhinë, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Sektorin e Financës, të merren masa për kontabilizimin, shpalljen debitorë dhe arkëtimin e vlerës së dëmit.

Brenda 9 muajit 2014

2. Në shumën **1,305,400 lekë**, nga e cila, **për vlerën 829,400 lekë nga z. K.K.** në cilësinë e ish Përgjegjësit Sektorit të Financës për vitin 2011 dhe 3/muajin e parë të vitit 2012, si dhe

për **vlerën 476,000 lekë nga z. F.M.**, si përgjegjës ekzistues i Sektorit të Financës, për vitin 2013, pasi janë kryer shpenzime për riparim autoveturash pa u cilësuar mjeti që do të riparohet. Në asnjë rast nuk ka ndonjë dokument ku të vërtetohej nevoja e riparimit. Në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar lloji i mjetit, apo targa e mjetit që do të riparohet, e konkretisht:

- Me urdhër shpenzimin nr. 14, datë 25.02.2011 “Riparim autoveture” në **shumën 27.400 lekë** në formularin 3 dhe 4 nuk kanë firmosur të gjithë anëtarët e komisionit, por vetëm **K.K.** ish përgjegjësi i Sektorit të Financës. Në faturë nuk është cilësuar se cili mjet do të riparohet dhe as targa e mjetit që riparohet.

- Me Urdhër Shpenzimin nr. 85, datë 19.09.2011 në vlerën **519,500 lekë**, për riparime makine, nuk është cilësuar se cili mjet do të riparohet dhe as targa e mjetit që riparohet. Përveç mungesave të dokumenteve të mësipërm, prokurimi duhej të kryej me tender. Për këtë mban përgjegjësi ish përgjegjësi i Sektorit të Financës.

- Me Urdhër Shpenzimit nr. 62, datë 12.3.2012 në **vlerën 282,500 lekë**, është kryer riparime makine pa përcaktuar mjetin që do të riparohet, targën e makinës, mungon procesverbali i kërkesës për riparimin e makinës dhe procesverbali i kolaudit për marrjen në dorëzim. Në formularin 3 dhe 4 nuk kanë firmosur të gjithë anëtarët e komisionit, por vetëm z. Kadri Kashari, dhe as në faturë nuk është shënuar targa e mjetit që riparohet. Për këtë mban përgjegjësi ish përgjegjësi i Sektorit të Financës.

- Me urdhër shpenzimi nr. 76, datë 08.04.2013, **lekë 476,000**, është kryer shpenzim për riparim makine, pa shënuar nevojën e riparimit, targën e automjetit, mungon procesverbali i kolaudit të marrjes në dorëzim, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi z. Fatmir Murati si Përgjegjës Sektorit të Financës.

Brenda 9 mujorit 2014

3. Në shumën 1,157,500 lekë nga z. Kadri Kashari në cilësinë e ish Përgjegjësit Sektorit të Financës për vitin 2011 dhe 3/mujorin e parë të vitit 2012, pasi janë kryer shpenzime për trajtimin e sportistëve me dieta, shpenzime transporti e akomodimi në hotel, në mungesa të theksuara të dokumentacionit financiar dhe që bien në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës punës”, e konkretisht:

- Me Urdhër Shpenzimin nr. 15, datë 25.02.2011 në **vlerën 472,500 lekë** “Akomodim sportistësh”, janë kryer shpenzime për akomodim në hotel, pa faturë tatimore të hotelit.

- Me Urdhër Shpenzimin nr. 39, datë 07.10.2011 në **vlerën 253,000 lekë** “Udhëtim e dieta” nga Ekipi Futbollit “Egnatia”, në Peshkopi, 115,000 lekë për akomodim në hotel +115,000 lekë dieta + 23,000 lekë shpenzime transporti, pa asnjë dokument shoqërues, si faturë tatimore e hotelit, urdhër shërbimi, bileta transporti, kërkesa këto të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës punës”, por janë me lista të firmosura vetëm nga përgjegjësi ekipit.

- Me Urdhër Shpenzimi nr. 41 datë 20.10.2011, në vlerën **387,000 lekë**, për dieta në shumën 207,000 lekë dhe premio në shumën 180,000 lekë të firmosura vetëm nga Kadri Kashari, përgjegjës i Sektorit të Financës.

- Me Urdhër Shpenzimi nr. 42 datë 20.10.2011, në **vlerën 45,000 lekë**, shpenzime transporti, pa bileta udhëtimi, të firmosura vetëm nga Kadri Kashari, përgjegjës i Sektorit të Financës.

Brenda 9 mujorit 2014

4. Në shumën 240,000 lekë nga z. K.K. në cilësinë e ish Përgjegjësit Sektorit të financës për vitin 2011 dhe 3/mujorin e parë të vitit 2012 dhe që ka kryer likuidimin me urdhër shpenzimin nr. 21, datë 12.12.201 për artikullin “Pako për vitin e ri”, pa u bërë mallrat më parë hyrje në magazinë dhe janë firmosur vetëm prej tij.

Brenda 9 mujorit 2014

5. Në shumën **300,686 lekë nga z. K.K.** në cilësinë e ish Përgjegjësitorit të Financës për vitin 2011 dhe 3/mujorin e parë të vitit 2012, pasi ka kryer likuidimin me urdhër shpenzimit nr. 20, datë 12.12.2011 të faturës për “Materiale mirëmbajtje”, të nënshkruar vetëm prej tij dhe pa u bërë mallrat më parë hyrje në magazinë.

Brenda 9 muhorit 2014

6. Në shumën **133,000 lekë nga z. K.K.** në cilësinë e ish Përgjegjësitorit të financës për vitin 2011 dhe 3/mujorin e parë të vitit 2012, pasi ka kryer likuidimin me urdhër shpenzimit nr. 120, datë 5.12.2011 të faturës për “Materiale mirëmbajtje”, të nënshkruar vetëm prej tij dhe pa u bërë mallrat më parë hyrje në magazinë.

Brenda 9 muhorit 2014

7. Në shumën **22,000 lekë nga z. K.K.** në cilësinë e ish Përgjegjësitorit të financës për vitin 2011 dhe 3/mujorin e parë të vitit 2012, pasi ka kryer likuidimin me urdhër shpenzimit nr. 42, datë 25.4.2011 të faturës për “Bojë fotokopje”, të nënshkruar vetëm prej tij dhe pa u bërë mallrat më parë hyrje në magazinë.

Brenda 9 muhorit 2014

8. Në shumën **36,400 lekë nga z. K.K.** në cilësinë e ish Përgjegjësitorit të financës për vitin 2011 dhe 3/mujorin e parë të vitit 2012, pasi ka kryer likuidimin me urdhër shpenzimit nr. 3, datë 9.4.2011 të faturës për “Riparim karrige shkolle”, pasi mungon procesverbali i marrjes në dorëzim nga shkollat pas rregullimit dhe pa asnjë dokument që të vërtetojë kryerjen riparimit të karrigeve. Për këtë veprim ngarkohet me përgjegjësi për të zhdëmtuar arkën e shtetit, pasi ky veprim nuk dokumentohet.

Brenda 9 muhorit 2014

9. Në shumën **51,600 lekë nga Shoqëria “2...N” sh.p.k.**, përfaqësuar nga z. Z.Z., pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksion i Qendrës Shëndetësore” rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

Brenda 6 muhorit 2014

10. Në shumën **283,360 lekë (pa t.v.sh)**, nga Shoqëria “B...X” sh.p.k., përfaqësuar nga z. B.B., pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës së Xhamisë” rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

Brenda 6 muhorit 2014

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 14 të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

“Largim nga puna”

1. **F.M.**, me detyrë, ish Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave për periudhën 15.08.201, deri më 10.09.2013, aktualisht përgjegjës i Sektorit të Financës.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos plotësimin e dosjeve të subjekteve me dokumentacionin e nevojshëm si, Deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, Gent Planet apo planimetritë kjo për taksën e

ndërtesave, Akt-konstatimet apo Akt-verifikimet dhe mos nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit tatimor. Në kundërshtim me nenin 29/1 dhe 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar.

- Për mos kryerjen e kontrolleve të subjekteve në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”, Pika 10-Kontrolli tatimor.

- Për pajisjen me certifikatë transporti të 31 subjekteve, të paregjistruar në QKR, në kundërshtim me ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugorë” me ndryshime, Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugorë” me ndryshim, duke shkaktuar një dëm buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë në vlerën 2,296,000 lekë.

- Nuk janë zbatuar masat ligjore duke u mbyllur veprimtarinë dhe konfiskimin e materialeve, ndaj 32 subjekteve të paregjistruar në QKR, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë për vlerën **2,333,810 lekë**. Në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, ndryshuar me ligjin nr. 10,415, datë 07.04.2011 dhe neni 41-Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar sipas nenit 121 të këtij ligji.

- Për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve nga ana e zyrës së taksave Bashkia Rrogozhinë, për vitet 2011,2012 dhe 3 kësteve të vitit 2013, nuk është aplikuar dënim me gjobë për pagesat e vonuara për vlerën **1,399,375 lekë**, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, dt. 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore”.

- Nga mos organizimi i punës, më datën 31.12.2011, 31.12.2012 dhe 9-mujori 2013 për 4 lloje e taksave të popullatës përkatësisht; për taksën e tokës, banesave, pastrimi dhe ndriçimi , nuk kanë paguar detyrimet në vlerën **prej 10,345,000 lekë**.

- Në pozicionin aktual të përgjegjësit të Sektorit të Financës mban përgjegjësi, pasi nuk ka kërkuar të ngrihet komision me urdhër të veçantë për marrjen në dorëzim të mallit, sipas kërkesave të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b : “Për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet,.... Autoriteti kontraktor, mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 54, datë 15.7.2010 “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kapitulli VI, procedura për administrimin e vlerave monetare dhe materiale.

2. L.H., me detyrën e ish Inspektorit të Tatim Taksave për periudhën 01.08.2011, deri në 12.07.2013, aktualisht administrator i ndihmës ekonomike pranë Bashkisë.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos plotësimin e dosjeve të subjekteve me dokumentacionin e nevojshëm si, Deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, Gent Planet apo planimetritë kjo për taksën e ndërtesave, Akt-konstatimet apo Ak-verifikimet dhe mos nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit tatimor. Në kundërshtim me nenin 29/1 dhe 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar.

- Për mos kryerjen e kontrolleve të subjekteve në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”, Pika 10-Kontrolli tatimor.

- Për pajisjen me certifikatë transporti të 31 subjekteve, të paregjistruar në QKR, në kundërshtim me ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugorë” me ndryshime, Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugorë” me

ndryshim, duke shkaktuar një dëm buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë në vlerën 2,296,000 lekë.

-Nuk janë zbatuar masat ligjore duke u mbyllur veprimtarinë dhe konfiskimin e materialeve, ndaj 32 subjekteve të paregjistruar në QKR, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë për vlerën **2,333,810 lekë**. Në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, ndryshuar me ligjin nr. 10,415, datë 07.04.2011 dhe neni 41- Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar sipas neni 121 të këtij ligji.

-Për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve nga ana e zyrës së taksave Bashkia Rrogozhinë, për vitet 2011,2012 dhe 3 kësteve të vitit 2013, nuk është aplikuar dënim me gjobë për pagesat e vonuara për vlerën **1,399,375 lekë**, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, dt. 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore”

-Nga mos organizimi i punës, më datën 31.12.2011, 31.12.2012 dhe 9-mujori 2013 për 4 lloje e taksave të popullatës përkatësisht; për taksën e tokës, banesave, pastrimi dhe ndriçimi , nuk kanë paguar detyrimet në vlerën **prej 10,345,000 lekë**.

“Vërejtje me shkrim”

1. T.G., me detyrë jurist, në pozicionin e anëtarit të Njesisë së Prokurimit

2. S.K., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës, në pozicionin e anëtarit të Njesisë së Prokurimit

3. S.B., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve, në pozicionin e anëtarit të Njesisë së Prokurimit

Për shkeljet e mëposhtme:

Në kërkesat për kualifikim në tenderat e karburantit, nuk ishte kërkuar sa do të ishte numri i punonjësve të siguruar në sigurimet shoqërore, kërkesë kjo e neni 45 e 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe e DST, për të cilën mban përgjegjësi Njësia e prokurimit, si dhe nuk ishte kërkuar posedimi i të paktën një pike të shpërndarjes së karburantit në territorin e Bashkisë Rrogozhinë. Nuk ka përcaktim se nga kush janë hartuar specifikimet teknike.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Piro imeraaj dhe Luan Kuka më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT